Detyra e komisionit asht: me u kujdesue për zbatimin e drejt të dispozitave të Ligjit për Fondin toksuer bujq-suer të pasunis së përgjithëshme popullore dhe ndamjën e tokës organizatave bujq-sore si edhe të dispozitave të tjera të nxjerruna në bazë të këtij Ligji; kontrollon punën e Komisioneve të rrethit për fondin toksuer bujq-suer; vendos në shkallë të dytë në rastet e caktueme me ligj dhe kryen të gjitha punët e tjera të cilat, simbas materjes, do t'i përkitshin kompetencës së këtij komisioni.

III

Ky Vendim hyen në fuqi në ditën e marrjës së tij e do të botohet në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë-metohis”.

KËSHILLI EGZEKUTIV I KËSHILLIT POPULLUER TË KRAHINËS AUTONOME TË KOSOVË-METOHIS

Nr. 499
6 Qershier 1953
Prishtinë

SEKRETARI
Gorolub Popoviq d. v.

K R Y E T A R I
Fadil Hoxha, d. v.

Me qëllim përparimi të blegtoris dhe prodhimeve blegtorale në territorin e Krahinës Autonome të Kosovë-metohis, e në bazë të propozimit të Sekretarjatit për punët ekonomike të Këshillit populluer të KA të Kosovë-metohis, — Këshilli egzekutiv i Këshillit populluer të KA të Kosovë-metohis në bazë të nenit 54 të Statutit të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis dhe autorizimeve nga neni 18 i Vendimit për zbatimin e tij, në mbledhjen e VIII me datë 24 qershter 1953, muer

VENDIM

PËR FORMIMIN E STABILIMENTIT KRAHINUER PËR SELEKÇIONIMIN E BAKTIVE DHE KONTABILITETIN THEMELTARË NË PRISHTINË

1. — FORMOHET stabilimenti krahinuer për selekcionimin e baktive dhe kontabilitetin themeltarë si THEMELATË në buxhetin e Krahinës Autonome të Kosovë-metohis, me seli në Prishtinë.

Stabilimenti i ndodhet nën udhëheqjen e Sekretarjatit për punët e ekonomis të Këshillit populluer të KA të Kosovë-metohis.

2. — Këshilli populluer i Krahinës Autonome të Kosovë-metohis i siguron Stabilimentit mjetet materjale që i nevojiten për zhvillimin e selekcionimit të baktive dhe të mbarsjes artificiale si dhe për zhvillimin e kontabilitetit themeltar.

3. — Veprimtaria dhe fushëveprimi i Stabilimentit krahinuer për selekcionimin e baktive dhe kontabilitetin themeltarë përbahe:

a) Zgjedhje kafshët për shumzim dhe formon kope kafshës për shumzim;

b) Merr pjesë në punë për organizimin e ndamjes dhe shfrytëzimit të kafshëve shumëzuese mashkuj simbas rejonizimit racuer;

c) ban kontrollimin e mbajtjes dhe shfrytëzimit, si dhe kontrollimin e veçorive prodhuese të kafshëve të zgjedhuna për shumzim;

d) Mban kontabilitetin themeltar të kafshëve të zgjedhuna për shumzim;

e) Udhëheq dhe merr pjesë si ekspert në ndërzimin kafshëve mashkuj për shumzim të cilat do të sherbejnë për mbarsje;

f) Organizon, merr pjesë dhe ndihmon n'organizmin e ekspozitave blegtorale;

g) Lëshon dokumentat e duhuna mbi origjinen, veçorit shumëzuese e prodhuese të kafshëve.

4. — Stabilimenti kryen detyrët e veta me anën e ekspertave të vetë, seksioneve zooteknike, stacioneve blegtoro veterinarë, ekspertave blegtoral, fidanishteve edhe ekspertave të cilët i lehen në dispozicion nga themelatat, sipërmarrjet e organizatat tjera.

5. — Punën e stabilimentit e udhëheq drejtori i Stabilimentit Krahinuer për selekcionimin e kafshëve dhe kontabilitetin themeltar të cilin e emnon Këshilli egzekutiv i Këshillit populluer të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis.

6. — Për shqyrtimin e çështjeve profesionale e dhanjen e mendimeve dhe propozimeve profesionale mbi të gjitha çështjet nga fusha e blegtoris, Stabilimenti ka Këshill profesional të përballim prej ekspertave të cilët i emnon Sekretari i Sekretarjatit për punët e ekonomis pranë Këshillit populluer të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis e në bazë të propozimit të drejtorit të Stabilimentit për selekcionimin e kafshëve dhe kontabilitetin themeltar.

Këshilli profesional e thërret dhe punën e tij e udhëheq drejtori i Stabilimentit.

7. — Stabilimenti për selekcionimin e kafshëve dhe kontabilitetin themeltar ka rregullorën e vet me të cilin rregullon punën e Stabilimentit si dhe marrëdhënjet reciproke të Stabilimentit me sipërmarrje tjera, themelatat dhe organizatat kooperativiste për sa i përket antarsimit dhe kontributeve e shërbimeve të posaçme që Stabilimenti u banë atyne.

Këjo Rregullore e stabilimentit duhet patjetër të vërtetohet nga ana e Sekretarjatit për punët e ekonomis pranë Këshillit populluer të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis dhe vetëm mbas vërtetimit mundet me u zbatue.

8. — Me vendim të posaçëm të Këshillit egzekutiv të Këshillit populluer të Krahinës autonome të Kosovë-metohis do të caktohet struktura organizative dhe sistematizimi i vendeve të punës së Stabilimentit Krahinuer për selekcionimin e kafshëve dhe kontabilitetin themeltar.

9. — Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Sekretarijati për punët e ekonomis pranë Këshillit populluer të KA Kosovë-metohis.

10. — Ky vendim hyen në fuqi në ditën e marrëdhës dhe duhet të vërtetohet pa tjetër nga ana e Këshillit populluer të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis në bazë të nenit 18 të vendimit për zbatimin e Statutit të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis dhe pikrisht në mbledhjen e parë t'ardhëshme.

KËSHILLI EGZEKUTIV I KËSHILLIT POPULLUER TË KRAHINËS AUTONOME TË KOSOVË-METOHIS

Nr. 503

24 qershter 1953

Prishtinë

SEKRETARI

Gorolub Popoviq d. v.

KRYETARI

Fadil Hoxha d. v.

REGJISTRIM NE REGIJISTER

Ambëltorja e Kasum S. Rexhepit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugoive zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 14397 — Nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Ambëltorja e Trupaj Sh. Destanit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugoive zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 14373 — Nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Bukë-pjeksija e Jahir R. Kryeziut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugoive zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës në qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 14341 — Nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja likura-shitse-punuese e Riza Qerim nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugoive zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 14228 — Nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpjeksija e Noc Lazar Lekajt nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugoive zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.


Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 13210 — Nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja lëkura-shitse-punuese e Muharem N. Babajonuzit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugoive zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 12854 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.



FLETORJA ZYRTARE

E KRAHINES AUTONOME TE KOSOVE — METOHIS NE
REPUBLIKEN POPULLORE TE SERBIS

Dispozitat e keshillave popullore

N^o 5

PRISHTINE 1 Korrik 1953

Vjeti VIII

Në bazë të nenit 57 pika 8 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve dhe të pikës 24 të vendimit të Këshillit egzekutiv Federativ për financimin dhe veprimtarin e themeltave shëndetsore, Këshilli populluer i rrethit të Gjillanit në mbledhjet e Dhomës së rrethit e të Dhomës së prodhuesave mbajtë me 4 qershter 1953, muer këtë

VENDIM

**MBI LEHTSINAT NË PAGESËN E SHPENZIMEVE
TË SPITALIT TË QYTETASVE NGA TERITORI I
RRETHIT TË GILLANIT**

Neni 1

Personat me banim të përhershëm në teritorin e Gillanit të cilët nuk janë të siguruem socialisht gëzojnë lehtsina në pagimin e shpenzimeve të mjekimit, simbas dispozitave të këtij vendimi.

Neni 2

Për personat tatim i të cilve për vjetin e fundit nuk është ma i madh se 170 dinar për antar familje ose 630 dinar për krejt familje, shpenzimet e mjekimeve në spital bijnë tansisht në ngarkim të buxhetit të Këshillit populluer të rrethit Gjillanit.

Neni 3

Personat të cilët paguejnë në vjet tatim prej 170 deri 210 dinar për antar familje e ma së tepërmi prej 630 dinar për familje, paguejnë 50% të mjekimeve në spital e 50% i paguen Këshilli populluer i rrethit në Gillan.

Neni 4

Personat të cilët paguejnë në vjet tatim prej 210 deri 250 dinar për antar familje dhe ma së tepërmi prej 840 deri 1400 dinarë për familje, paguejnë 7% të shpenzimeve të spitalit, e 25% paguen Këshilli populluer i rrethit në Gillan.

Neni 5

Të gjithë personat e tjerë të cilët paguejnë tatim mase 350 dinarë për antar familje dhe mase 1400 dinarë për familje i paguejnë vet në tanësi shpenzimet e mjekimit në spital.

Neni 6

Shpenzimet e mbrojtjes shëndetsore të parapam me këtë vendim të cilat i paguen Këshilli populluer i rrethit në Gillan, do të njiën vetëm në rastë mjekimi në spitalet e shtetit në bazë të dërgimeve të mjekve t'autorizuem.

Të gjithë personat të cilët kanë të drejtë për mbrojtjen shëndetsore në bazë të këtij vendimi, e kanë për detyrë me sigurue certifikatat nga organet kompetente tatimor mbi naltsin e tatimit për çdo antar dhe krejt familjen e tij.

Neni 7

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesohet Pleqsija për shëndetin populluer e politikën sociale e këtij Këshilli.

Neni 8

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis“, e do të zbatohet nga data 1 Prill 1953.

**KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT
GILLANIT**

Nr. 4459

4 Qershter 1953
Gillan

KRYETARI
Adem Sulejmani d. v.

Në bazë të nenit 57 pika 10 e nenit 128 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve, Këshilli populluer i rrethit të Gillanit në mbledhjet e Dhomës së rrethit e të Dhomës së prodhuesave të mbajtura me datë 4 qershter 1953, muer këtë

VENDIM

**MBI NALTSIN E SHPËRBLIMIT KËSHILLTARVE,
ANTARVE TË PLEQSIVE, KËSHILLAVE E KOMI-
SIONEVE GJATË KRYMJS SE DETYRËS KË-
SHILLTARIT GJEGJSISHT ANTARIT TË PLEQIS,
KËSHILLAVE E KOMISIONEVE**

Neni 1

Këshilltarve të Këshillit populluer të rrethit në Gillan n'emën të shpërblimit të shpenzimeve dhe fitimit të humbun për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit populluer u takojnë nga 500 dinar në ditë.

Neni 2

Antarvë të pleqsive, Këshillave e Komisioneve të Këshillit populluer të rrethit të Gillanit gjatë kohës së kryemjës së detyrës n'organet e përmenduna u përket shpërblimi në të holla për shpenzimet dhe mëditjen e humbun në kryemjen e detyrës nga 360 dinar në ditë.

Neni 3

Personat nga neni 2 e 3 të këtij vendimi të cilët banojnë në selin e rrethit do të marrin krejt shumën e mëditjës së humbun në kryemjen e detyrës në rastë se nuk marrin shpërblimin e mëditjës nga sipërmarrjet ose themeltat ku punojnë.

Neni 4

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis“.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT GILLAN

Nr. 27 53 Gillan 4 qershter 1953

KRYETARI Adem Sulejmani d. v.

Në bazë të nenit 57 pikë 11 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve dhe pikës 24 të vendimit mbi financimin e veprimtarin e themeltave shëndetsore (Fletorja Zyrtare e RFPJ 14-53) Dhoma e rrethit e Dhoma e prodhuesave të Këshillit populluer të rrethit të Zveçanit në mbledhjen e datës 28 maj 1953, muerën këtë

VENDIM

**MBI MJEKIMIN NË SPITAL TË PERSONAVE TË
PA SIGURUEM, TË VORFUND DHE TË PA SIGU-
RUEM SOCIALISHT DHE MBI LEHTSINAT E
PAGESËS SË SHPENZIMEVE NË SPITAL NË TERI-
TORIN E KËSHILLIT POPULLUER TË RRETHIT
ZVEÇAN**

Neni 1

Të gjithë personat e parapam në nenin 6 e në lidhje me nenin 3 të Dekretit për llogaritjen e pagesës e shpenzimeve në spitalet shtetnorë dhe themeltat shëndetsore (Fletorja Zyrtare RFPJ Nr. 56-43) nga teritori i këtij Këshilli, gëzojnë mprojtjen shëndetsore dhe mjekimin pa pagesë pa u bazue në gjendjen e tyre ekonomike.

Neni 2

Të drejtën e mprojtjes shëndetsore dhe të mjekimit në Spital pa pagesë në bazë të këtij vendimi e kanë të gjithë personat të cilët marrin ndihmën e va-

zhdueshmë mujore nga arka e këtij Këshilli si: gëzuesat e ndihmës së vazhdueshme sociale, gëzuesat e ndihmës kadrovike dhe të viktimave të terrorit fashist, me konditë që këjo ndihmë që paguhet prej këtij të jetë e vazhdueshme.

Neni 3

Të gjithë personat nga teritori i këtij Këshilli të cilët nuk janë debitue me tatim — nuk kanë t'ardhuna, e në kurfar baze nuk marrin kurfar ndihme të vazhdueshme, kanë të drejtë vetëm në mjekimin pa pagesë në spitale.

Neni 4

a) Personat t'ardhunat e të cilve për antar familjeje nuk kalojnë 10.000 dinar në vjet, kanë zbritje 75% në mjekimin e spitalit;

b) Personat t'ardhunat e të cilve për antar familjeje janë 10.000 deri 15.000 dinar kanë 50% zbritje për mjekime në spital;

c) Personat t'ardhunat e të cilve për antar familjeje kapin shumën vjetore prej 15.000 deri 20.000 dinar kanë 25% zbritje për mjekimet në spital.

Neni 5

Zbritjen në shpenzimet e mjekimit në spitale nga neni 3 e 4 të këtij vendimi e gëzojnë vetëm personat mjekimi i të cilve zgjatë ma tepër se 5 ditë.

Neni 6

Të gjitha shpenzimet e mbrojtjes shëndetsore dhe të mjekimit në spitale në lidhje me këtë vendim i paguen Këshilli populluer i rrethit të Zveçanit në Mitrovicë nga buxheti i vjetit 1953, me konditë që këta persona mos të shfrytzojnë mprojtjen shëndetsore në baza tjera.

Neni 7

Shpenzimet e mprojtës shëndetsore dhe të mjekimit në spitale do të njiën për shërbimet e bame në shtëpinë e shëndetit populluer dhe në Spitalin e për gjithëshëm në Mitrovicë.

Në rastë se ndokuejt i nevojitet mjekimi jashtë Mitrovice, shpenzimet do të njiën vetëm me konditë që ai person të ketë rekomadimin e mjekut për themelaten përkatse shëndetsore, gjegjisht rekomandimin e mjekut të Shtëpisë së shëndetit populluer në Mitrovicë.

Neni 8

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë-metohis”.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT ZVEÇANIT

Nr. 6465 28 maj 1953 Mitrovicë

KRYETARI Milija Cvetniq d. v.

Në bazë të nenit 14, 57 e 114 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve në lidhje me nenin 6 të të Ligjit për çdukjen e dameve ndër fusha, — Dhoma e rrethit e Dhoma e prodhuesave të Këshillit populluer të rrethit Podrimës në mbledhjen e vetë me datë 12 qershuer 1953 muerën këtë

VENDIM

MBI CAKTIMIN E SHPËRBLIMIT TË ROJTARVE TË FUSHAVE PËR KAFSHËT E ZANUNA NË DAM NËR FUSHA

Neni 1

Për çdo kafshë të trash të zanun në dam ndër fusha nga ana e rojtarve të fushave, pronari i kafshës së kapun do të paguej si shpërblim rojtarit fushës nga 50 dinar.

Neni 2

Për çdo kafsh t'imtë të kapun në dam ndër fusha nga ana e rojtarve të fushave, pronari i kafshës së kapun do të paguej si shpërblim

- a) për çdo derr të kapun në dam nga 30d.
- b) për çdo dele të kapun në dam nga 20d.
- c) për çdo dhi të kapun në dam nga 25d.

Neni 3

Në qoftë se kapën në dam kafshë të trasha ose t'ima në kope (tubë) ma të madhe se 20 kren, shpërblimi i rojtarve paksohet për 50% për çdo kafsh mbi 20 nga shuma caktueme në nenin 1 e 2 të këtij vendimi.

Neni 4

Shpërblimi i kapjes së kafshëve paguhet nga ana e pronarve të kafshëve në dam në Këshillin populluer të Komunës, e ky mbas pagimit të damit u a këthen pronarve kafshët, e mandej shpërblimin i a paguen atij rojtarit të fushës i cili e ka kapë kafshën në dorë.

Neni 5

Ky vendim vlen për të gjithë Këshillat popullore të Komunëve në teritorin e rrethit.

Neni 5

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletoren Zyrtarë të KA të Kosovë-metohis”

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT TË PODRIMËS
Nr. 6413 12 qershuer 1953 Rakovec

KRYETARI Qamil Sharku d. v.

Në bazë të nenit 7 alineja e fundit të Dekretit mbi shpenzimet e udhëtimit e transferimit dhe të nenit 14 e 57 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rrethit e qyteteve, — Dhoma e rrethit e Dhoma e prodhuesave të Këshillit populluer të rrethit të Podrimës në mbledhjen e datës 12 Qershuer 1953, muer këtë:

VENDIM

MBI NALTËSIN E MËDITJEVE PËR UDHËTIME ZYRTARE NË KUFIJT E RRETHIT TË PODRIMËS

Neni 1

Naltsija e mëditjeve për udhëtimet zyrtare në kufijt e rrethit të Podrimës kapë 70% të naltësis së mëditjeve të parapame në nenin 7 alineja 1 të Dekretit mbi shpenzimet e udhëtimit e transferimit.

Neni 2

Ky vendim i Këshillit populluer të rrethit do të zbatohet pranë të gjitha themelatave e zyrave vep-rintaria e të cilave asht kufizue, në teritorin e rrethit, pa marrë parasysh në se ajo themelat ose zyrë asht federative apo republikane.

Neni 3

Me këtë vendim bjen nga fuqija vendimi i Këshillit populluer të rrethit Nr. 10836 datë 20 Dhetuer 1952.

Neni 4

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë — metohis”.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT TË PODRIMËS
Nr. 6413 12 qershuer 1953 Rakovec

KRYETARI Qamil Sharku d. v.

Në bazë të nenit 57 pika 10 e nenit 128 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve, — Dhoma e rrethit e Dhoma e prodhuesave të Këshillit populluer të rrethit Podrimës në mbledhjen e datës 12 qershuer 1953 muerën këtë.

VENDIM

MBI NALTËSIN E MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË FITIMEVE TË HUMBUNA KËSHILLTARVE DHE ANTARVE TË PLEQSIVE E KOMISIONEVE TË KËSHILLIT POPULLUER TË RRETHIT TË PODRIMËS

Neni 1

Këshilltarët, antarët e pleqsive dhe të Komisioneve të Këshillit populluer të rrethit të Podrimës kur vijnë në mbledhje të Këshillit, të pleqsis e komisionit kanë të drejtë shpërblimi të shpenzimeve dhe shpërblimi të fitimit të humbun në shumat dhe mënyrën e parapame në këtë vendim.

Neni 2

Personat nga neni i mapërparshëm të cilët banojnë jashtë selis së rrethit do të marrin si shpërblim për mëditjen e humbun nga 370 dinar.

Neni 3

Këshilltarët, antarët e pleqsive e komisioneve të cilët banojnë në selin e rrethit, simbas rregullit, nuk kanë të drejtë shpërblimi shpenzimesh, por kanë të drejtë shpërblimi për fitimin e humbun në qoftë se nuk paguhën prej themelatave ose sipërmarrjeve ku punojnë në kohën kur marrin pjesë në mbledhjet e këshillit, pleqsis ose të komisionit.

Neni 4

Shpërblimin për fitimin e humbun do t'a marrin personat nga neni i mapërparshëm në naltësi të fitimit të humbun për kohën që kryejnë detyrën në këshill, pleqsi ose komision.

Neni 5

Pagesa e shpenzimeve dhe e shpërblimit të fitimit të humbun do të bahet me rastin e ardhjes së këshilltarve dhe antarve të pleqsis në mbledhje.

Neni 6

Me këtë vendim nxirret jashtë fuqis vendimi i këtij Këshilli Nr. 10836 datë 20 dhetuer 1952

Neni 7

Ky vendim hyen në fuqi me ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë — metohis”.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT TË PODRIMËS

Nr. 6413 12 Qershter 1953 Rakovec

KRYETARI Qamil Sharku d. v.

Në bazë të nenit 1 e 2 të Dekretit për ndamjen e fondit të mirëmbajtjes së ndërtesave (Fletorja Zyrtare e RFPJ Nr. 12/53) dhe të komuneve të qytetit, — Këshillit populluer i Komunës së qytetit në Pejë në mbledhjen e datës 20 Prill 1953, muer këtë

**VENDIM
PËR NDAMJEN E FONDIT TË MIRËMBAJTJES
SË NDRËTESAVE**

Neni 1

Me qëllim meremetimi të ndërtesave nga të cilat rrjedhin mjetet e pagueme në fondin për mirëmbajtjen e ndërtesave, u caktohet pronarve të ndërtesave shfrytëzimi i këtij fondi në këto përqindje:

- Për ndërtesën e kategoris së parë 30%
- Për ndërtesën e kategoris së dytë 40%
- Për ndërtesën e kategoris së tretë 50%

Të gjitha diferencat të tjera i mbetën këtij Këshilli i cili do t'i përdorë për mirëmbajtjen dhe ndertimin e fondit të banesave në teritorin e Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Pejë.

Neni 2

Në frymë të nenit 1 të këtij vendimi kategorive u përkasin këto ndërtesa:

- në kategorin e parë ndërtesat me materijal të fortë, me dhoma të shëndritshme e të ajrosuna, me mure të fortë e të mistrueme e plafone pa lagshti dhe me naltisi minimale 2,80 m të dhomave;
- në kategorin e dytë hyjnë ndërtesat e ngjashme me ato të kategoris së parë me disa të meta të vogla, me ma pakë ndriçim, me plafon të thjesht prej materijali mesatar ndertimuer, me pakë lagshti dhe me naltisi mesatare 2,40 m.;
- në kategorin e tretë hyjnë ndërtesat me materijal të dobët, të pa mbrojtuna sa duhet prej lagshtinës, të pashëndritshme sa duhet dhe me naltësin e mureve prej 2,40 m. —

Neni 3

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare” të KA të Kosove Metohis.

KËSHILLI POPULLER I KOMUNËS SË QYTETIT

NË PEJË

Nr. 7763/53 20 prill 1953 Pejë

KRYETARI Mehmet Shoshi d. v.

Në bazë të nenit 57 alineja 2 pika 2 të Ligjit mbi Këshillat popullorë të qyteteve e komuneve të qytetit, Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Pejë në mbledhjen e datës 20 Prill 1953, muer këtë:

**VENDIM
PËR MIRËMBAJTJEN E KOPSHTEVE PUBLIKE
BREZIT TË DRUJVE, SIPËFAQEVE TË BLERTA
E TË PYLLSUEME NË TERITORIN E KËSHILLIT
POPULLUER**

TË KOMUNËS SË QYTETIT NË PEJË

Neni 1

Blerimet e qytetit dhe sipërfaqet e blerta përfshijnë të gjitha sipërfaqet pylltare, kopshtet publike, vend shetitjet, vorrezat, fushat fiskulturale, druajt në vijë të drejtë dhe terent tjera të blerueme në teritorin e Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Pejë.

Neni 2

Me rastin e përdorimit gjegjësisht shfrytëzimit të blerimeve, kopshteve publike, fushave fiskulturale, vorrezave dhe të të gjitha sipërfaqeve të blerueme e të pyllzumeve dhe t'objekteve në to, qytetasit e kanë për detyrë me u kujdesue për to dhe t'i mbajnë mirë.

Neni 3

Me gjobë deri në 2000 dinar do të ndëshkohet:

- a) Kush këput lule, shtrihet mbi bar, damton bankat dhe hasherimet e drujave në vijë të drejtë.
- b) Kush lëshon qenin në kopshtet publikë dhe sipërfaqet e blerueme;
- c) Kush kalon me biciklet nëpër rrugicat e kopshteve publikë dhe të sipërfaqeve të blerueme.

Me gjobë deri në 50 dinar do të ndëshkohet: Kush banë bankat prej një vendi në vend tjetër.

Neni 4

N'alinen 2 e 3 të Nenit 3 të këtij Vendimi autorizohën antaret e Milicis popullorë dhe ruejtsat e kopshteve publike që gjobën t'a marrin në vendin e duhur menjherë mbas krymjes së fajit tue i lëshue dëftesë.

Në bazë t'alines 1 të nenit 3 të këtij vendimi procedurën administrative ndeshkrimore e zhvillon dhe ndëshkimin e jep gjyqtari për kundravajtje pranë këtij Këshilli.

Neni 5

Për kudravajtjet nga ana e personave të pa emnaçipuem përgjigjën prindët ose tutorët e tyre.

Neni 6

Ky vend hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë — Metohis”.

**KËSHILLI POPULLUER I KOMUNËS SË QYTETIT
NË PEJË**

Nr. 7767

20 prill 1953

Pejë

**KRYETARI
MEHMET SHOSHI d. v.**

Në bazë të nenit 14 e 61 të Ligjit mbi Këshillat popullorë të rretheve, nenit 8 pika c) të Ligjit themeltar mbi kudravajtjet e në bazë të nenit 2 e 4 alineja 2 të Dekretit mbi dhanjen me qira të lokale të punës, — Këshillit populluer i rrethit, të Sharplaninën në mbledhjen e dhomës së rrethit me datë 12 maj 1952, muer këtë:

VENDIM

**PËR DHANJEN ME QIRA TË LOKALEVE TË
PUNËS NË TERITORIN E RRETHIT TË SHARPLANINËS**

Neni 1

Lokalet e punës në teritorin e rrethit, përveç të Komunës së qytetit, i japin me qira pronarët e ndërtesave në bazë të kontraktimit të lirë me qiradhansit në pajtim me dispozitat e Dekretit për dhanjen me qira të lokaleve të punës dhe të këtij vendimi.

Neni 2

Si lokalet e punës konsiderohën: të gjitha lokalet që shërbejnë për zhvillimin e veprimtaris ekonomike, për zyra, për depozitim e malnave e veprimtarina tjera.

Neni 3

Qiradhansi dhe qiramarsi e kanë për detyrë me lidhë kontratë me shkrim mbi qiran. Në kontratën e qiras, përveç të tjerash duhet me parapaj:

- 1) qiran muejore;
- 2) afatin e zgjatës së kontratës;
- 3) detyrimet në pikëpamje të mbajtës së lokalit të punës.

Neni 4

Nji muej para skadimit të kontratës qiradhansi e qiramarsit mundën me denoncue marrëdhjet me kontratë.

Në qoftë se marrëdhjet nuk denoncohen n'afatin nga alineja e masipërme, vlefte e kontratës zgjatet për atë kohë për sa asht lidhë kontrata, e në këtë periudh marrëdhjet mund të denoncohen vetëm në bazë të marrëveshtjes reciproke.

Neni 5

Detyrimet e lidhjes së kontratave me shkrim iu përkasin edhe qirave të tashme të lokaleve të punës për të cilat nuk ka kontratë me shkrim.

Kontratat që janë të lidhuna duhet të përshtatën simbas dispozitave të këtij vendimi.

Neni 6

Kontratat nga neni 3 e 5 të këtij vendimi duhet të lidhën gjegjësisht të përshtatën në bazë të dispozitave të këtij vendimi mbrenda 15 ditve mbas hymjes në fuqi të këtij.

Neni 7

Pagesa e qirave si edhe kontributi në fondin e mirëmbajtës së ndërtesave do të bahën në bazë të dispozitave të Dekretit për dhanjen me qira të lokaleve të punës.

Neni 8

Qiradhansi e ka për detyrë që një kopje të kontratës së qiras dhe të gjitha ndryshimet e matejshme të kontratës t'i a paraqesi Drejtoris së t'ardhunave të këtij Këshilli mbrenda 8 dite mbas lidhjes gjegjësisht mbas ndryshimit të kontratës

Neni 9

Me gjobë deri në 3000 dinar do të ndeshkohet qiradhansi e qiramarsi për shkelje të neneve 3,5 e 6, ndërsa qiradhansi edhe për shkelje të nenit 8 të këtij Vendimi.

Neni 10

Ky vendim hyen në fuqi kur të shpallët në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë-metohis.

Nr. 5145/53

12 maj 1953

Prizren

KRYETARI

Ali Dauti d. v.

Në bazë të nenit 61 pika 1 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve, në lidhje me nenin 6 të Ligjit për çdukjen e dameve ndër fusha dhe pikë 9 t'Udhëzimeve për rrogat e shpërblimet e rojtsave të fushës, — Dhoma e rrethit të Këshillit populluer të Rrethit të Gorës në mbledhjen e vetë me datë 16 Qershuer 1953 muer këtë

VENDIM

MBI NALTËSIN E SHPËRBLIMIT NË DOBI TË BOJTSAVE TË FUSHËS PËR KAFSHËT E KAPUNA NË DAM NDËR FUSHË NË TERITORIN E RRETHIT TË GORËS

Neni 1

Rojtsat e fushave të Këshillave popullore të Komuneve në rrethin e Gorës kanë të drejtë shpërblimi në të holla në rastë se kapin në dam ndër fusha kafshët pa barijë ose pronari i të cilave nuk dihet, me konditë që kafshët e kapuna t' përgojmë në Këshillin përkatës populluer të Komunës.

Neni 2

Ky shpërblim asht si vijon:

—për kafshët e ima për çdo kren 20 dinar.

— për kafshët e trasha për një kren 50 dinar.

Neni 3

Në rastë se rojtsi i fushave kapë në dam ndër fusha kafshët në kope ma të madhe se 20 kren, shpërblimi për çdo kren mbi 20 paksohet 50 përqind nga shuma e caktueme në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 4

Pagesën e këtij shpërblimi simbas këtij vendimi do t'a bajë Këshilli populluer i komunës në frymë t'udhëzimeve t'ish Ministris së bujqësis të RPS Nr. 10756 datë 6 IV. 1951 (Fletorja Zyrtare e RPS Nr. 15/15).

Neni 5

Ky vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në Fletorën zyrtare të KA të Kosovë-metohis e do të shpallet edhe në mënyrët e zakonshme.

DHOMA E RRETHIT TË KËSHILLIT POPULLUER TË RRETHIT GORËS

Nr. 4461 16.VI.1953

KRYETARI

I KËSHILLIT POPULLUER TË RRETHIT

Maksud Skenderi d. v.

Në bazë të nenit 57 pika 10 dhe nenit 128 të Ligjit mbi Këshillat popullore të rretheve, — Dhoma e rrethit e Dhoma e prodhuesave të Këshillit populluer të rrethit të Gorës në mbledhjet e veta me datë 16. VI. 1953 muerrën këtë

VENDIM

MBI NALTËSIN E SHPËRBLIMIT KYSHILLTARVE, ANTARVE TË PLEQSIVE, KËSHILLAVE TË PLEQSIVE E KOMISIONEVE

Neni 1

Këshilltarve, antarve të pleqsis, të këshillave të pleqsis e komisioneve gjatë kohës së krymjes së

detyrës n'organet e përmenduna u përket shpërblimi në të holla për shpenzimet dhe fitimin e humbun gjatë kohës kur kryejnë detyrën e këshilltarit, t'antarit të pleqsis, të Këshillit pleqsis e Komisionit.

Neni 2

Personat nga neni i përparshëm të cilët banojnë jasht selis së rrethit do të marrin shpërblimin për shpenzimet dhe fitimin e humbun nga 300 dinar

Personat nga neni i ma përparshëm të cilët banojnë në selin e rrethit do të marrin tanësisht shumën e fitimit të humbun gjatë kohës kur kryejnë detyrën e këshilltarit, t'antarit të pleqsis, të këshillit të pleqsis e komisionit, në qoftë se ata persona për këtë kohë nuk marrin shpërblimin nga sipërmarrja gjegjësisht themelata ku punojnë.

Neni 3

Ky Vendim hyen në fuqi në ditën e kumtimit në „Fletorën Zyrtare të KA të Kosovë-metohis”.

KËSHILLI POPULLUER I RRETHIT TË GORËS NË DRAGASH

Nr. 4460 16 Qershuer 1953 Dragash.

KRYETARI Maksud Skenderi d. v.

DISPOZITAT E KËSHILLAVE POPULORE

1. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit Gjillanit mbi lehtsinat në pagesën e shpenzimeve të spitalit të qytetasve nga teritori i rrethit të Gjillanit.

2. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit Gilanit mbi naltësin e shpërblimit të këshilltarve, antarve të pleqsis, këshillave e komisioneve gjatë kryemjes së detyrës së këshilltarit gjegjësisht antarit të pleqsis, këshillave e komisioneve.

3. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit Zveqanit mbi mjekimin në spital të personave të pasiguruem socialisht dhe mbi lehtsinat e pagesës së shpenzimeve në spital në teritorin e Këshillit populluer të rrethit Zveqan.

4. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit Podrimës mbi caktimin e shpërblimit të rojtarve të fushave për kafshët e zanuna në dam ndër fusha.

5. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit Podrimës mbi naltësin e mëditjeve për udhëtimet zyrtare në kufijt e rrethit të podrimës.

6. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit Podrimës mbi naltësin e mënyrën e shpërblimit të shpenzimeve të ftimeve të humbuna këshilltarve dhe antarve të pleqsis e komisioneve të Këshillit populluer të rrethit të Podrimës.

7. Vendimi i Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Pejë për ndamjen e fondit të mirëmbajtjes së ndërtesave.

8. Vendimi i Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Pejë për mirëmbajtjen e kopshteve publike, brezit të drujve, sipërfaqeve të blerta, e të pyllzume në teritorin e Këshillit populluer të komunës së qytetit në Pejë.

9. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit të sharplaninës për dhanjen me qira të lokaleve të punës në teritorin e rrethit të sharplaninës.

10. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit gorës mbi naltësin e shpërblimit në dobi të rojtësave të fushës për kafshët e kapuna në dam ndër fusha në teritorin e rrethit të gorës.

11. Vendimi i Këshillit populluer të rrethit gorës mbi naltësin e shpërblimit këshilltarve, antarve të pleqsis, këshillave të pleqsis e komisioneve për kohën e kryemjes së detyrës të këshilltarit, gjegjësisht t'antarave të pleqsis, këshillave të pleqsis e komisioneve

Farkatarija e Sulejman Osman Halabakut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare e të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 12589 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren

Dugoja zdrukthetare e Lutvi V. Kotorrit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 11646 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpeksija e Gani Kadri Qollakut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 11633 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Ambëltorija e Sylejman A. Xhejlanit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 14341 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Ambeltorja e Rexhep Shahsivar Arushës nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 11212 — Nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Puntorija Mekanike e Janković Dushanit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 12329 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Sarashonja e Xhevat Nuri Fejzës nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 13436 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Sarashonja e Agim Zija Nijazi nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 5277 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpeksija e Salih Qazim Kurejshit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 2679 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Puntorija e kacave e Hysein Lutfula Kiliqit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 1273 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja ngjyra-bamëse e Fahredin J. Zurmaxhiut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

zejtare të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 2519 — nga Këshilli populluer i Komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja ngjyra-bamëse e Fahredin J. Zurmaxhiut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 12436 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpeksija e Selim Ramizit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 24832 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpeksija e Adam Halil Kryeziut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 22632 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja këpuca bamëse e Xhemal Mahmud Shehut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 22472 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpeksija e Vesel A. Bublakut nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 22452 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja arkatare e Hasan Liman Ibrahimoviqit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 22332 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja opinga-punuese e Stevan Benxharevqit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 21775 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja çerga-punuese e Miodrag Gjuriqit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 19053 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Mbathëstorja e Sulejman Ibrahim Opoja nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18771 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Sarashonja e Murat Jakup Spahis nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojeve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

puntorinave të Këshillit populluer të Komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18770 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Bukëpjeksija e Sherif Muharrem Qoqajt nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18735 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Mbathëtorja e Bajram M. Zhables nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18421 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Saraçonja e Aqif Rexhep Shalës nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18418 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Dugoja çerga-punuese e Evangelij Furjanoviçit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18411 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Ambeltorja e Nusret Ukës nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 18057 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Robaqepsija e Xhevdet Ismail Nurës nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 17501 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Rojtorja e Sulejman Zjadinit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 16945 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Ambeltorja e Adem Sulejman Dapkos nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 15119 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Rojtorja e Jusuf E. Dorës nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 3105 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Puntorija e kacave e Rasim S. Potorit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 1275 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Saraçonja e Bajram Qemal Kazazit nga Prizreni asht regjistruar në regjistrin e dugojve zejtare dhe të puntorinave të Këshillit populluer të komunës së qytetit në Prizren.

Dugojën do t'a firmojë pronari.

Nr. 965 — nga Këshilli populluer i komunës së qytetit në Prizren.

Drejtorija e t'ardhunave e Këshillit populluer të rrethit Llapit ka regjistruar në regjistër të sektorit kooperativ pasunin bujqësore „OSHTRO KOPLE” me seli në Kërprim.

Landa e veprimtaris asht: prodhimtaria bujqësore dhe komercijaliste.

Firmën me plotë fuqi do t'a nënshkruaj Drago-
viq Miliq, drejtori, dhe Obradoviç Radomir, llogaritar mbrenda naltësis se kredinave të caktueme.

Nr. 7883 — nga Drejtorija e t'ardhunave të Këshillit populluer të rrethit Llapit në Podujevë.

SHPALLJET

Dëftesën shkollore mbi kryemjen e klasë së tetë të gjymnazit, të lëshueme nga ana e Gjymnazit shqiptar në Prishtinë për vjetin shkollor 1950-51 n'emën të Adem Devajës e deklaroj të pavlefshme mbassi më ka humbë.

ADEM DEVANA

Rruga Dragi Popoviç Nr. 27
Gjilan

Diplomën për kryemjen e Shkollës së mesme teknike në Prishtinë të lëshueme mbrenda vjetit 1951 n'emën të Kurtesh Ahmetit e deklaroj të pavlefshme mbassi më ka humbë.

Kurtesh Ahmeti

Mësimdhanës i gjimnazit shqiptar
Gjilan

Diftesën për mbarimin e Shkollës mesme medicinare në Nish, në emën Millutin Nikoliq e kam humbë dhe e deklaroj të pavlefshme.

Millutin Nikoliq
nëpunës i spitalit në
Prishtinë

NDREQJE GABIMI

Në numërin 4 të „Gazetës zyrtare të KA Kosovës-metohis” janë lëshue këto gabime:

Vendimi për emnimin e direktorit për selekcionimin e kafshëve dhe kontabilitetin themeltar duhet të ndreqet si vijon:

VENDIM

MBI EMNIMIN E DREJTORIT TË ENTIT KRAHINUER PËR SELEKCONIMIN E KAFSHEVE E KONTABILITETIN THEMELTAR

Në faqen 57 të vendimit mbi shpalljen e zgjedhjeve për një vend të shprazët këshilltari të dhomës së prodhuesave të Këshillit rrethit Istokut gabimisht asht botue se zgjedhjet do të bahen me 8 gusht kurse duhet të jetë me 9 gusht.

PËRMBAJTJE:

1. Vendimi i Këshillit egzekutiv të Këshillit populluer të KA të Kosovë-metohis mbi naltësin e shpërbllimit të shpenzimeve dhe të fitimeve të humbuna këshilltarve të Këshillit populluer të Krahinës Autonome të Kosovë-metohis.

2. Vendimi i Këshillit egzekutiv të Këshillit populluer të KA të Kosovë-metohis. Për formimin e Komisionit për fondin toksuer bujqësuer të Krahinës autonome të Kosovë-metohis.

3. Vendimi i Këshillit egzekutiv të Këshillit populluer të KA të Kosovë-metohis për formimin e Stabilitetit Krahinuer për selekcionimin e baktive dhe kontabilitetin themeltar në Prishtinë.

**REGJISTRIM NË REGJISTËR
SHPALLJET.**

Dorëshkrimet dhe shpalljet të dërgohen në adresën: Administrata e „Gazetës Zyrtare të K. A. Kosovë — Metohis” në Prishtinë — Nr. i llogaris rrjedhëse 380 — T — 261. Redaktor përgjegjës Mirko Pajoviç, Prishtinë, tel. 539



СЛУЖБЕНИ ЛИСТ

Аутономне области Косова и Метохије

Бр. 5

ПРИШТИНА 1 јули 1953

год. VIII

На основу чл. 37 и чл. 58 Статута Аутономне Области Косова и Метохије и овлашћења из чл. 18 Одлуке о спровођењу Статута, Извршно веће Народног одбора Аутономне Области Косова и Метохије на својој VI седници од 14 маја 1953 године, донело је

РЕШЕЊЕ

О ВИСИНИ И НАКНАДИ ТРОШКОВА И ИЗГУБЉЕНИХ ЗАРАДА ОДБОРНИЦИМА НАРОДНОГ ОДБОРА АУТОНОМНЕ ОБЛАСТИ КОСОВА И МЕТОХИЈЕ

